



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr. 8510 Prot.

Tiranë më, 05/05 /2021

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Adresa	Rr. "Muhedin Llagani", Nr. 10 Tiranë.
Tel/Fax	0355 688015833
E-mail	dpshttr@dpshttr.gov.al
Faqja e Internetit	www.dpshttr.gov.al

OBJEKTI:

**PËR BLERJEN E NJË TRUALLI DHE GODINË PËR SISTEMIMIN E PUNONJËSVE
TË DPSHTRR-së**

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor njofton të interesuarit/ofertuesit se kërkon të blejë truall dhe godinë për sistemimin e punonjësve të DPSHTRR-së, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Në truallin dhe objektin e kërkuar të ketë hapësirë për zhvillimin e Testimit Praktik të Kandidatëve të DRSHTRR Tiranë, min 4000 m2. Kjo sipërfaqe të jetë e rrethuar, e ndarë nga ambientet e tjera, e ndriçuar, e shtruar me asfalt, e pajisur me sinjalistikë për qëllimin e kërkuar;
- Sipërfaqe ndërtimi jo më pak se 2000 m2, lartësia e katit jo më pak se 3 m, e përshtatshme për zyra, e pajisur me infrastrukturën elektrike, sistem kondicionimi, ndriçim dhe me ndarje funksionale.
- Objekti duhet të jetë në kushte optimale dhe të mos ketë nevojë për ndërhyrje/riparime;
- Sipërfaqe truall jo më pak se 5000 m2, e rrethuar, e sistemuar dhe e shtruar me asfalt/beton.
- Të ketë një ambient / hapësirë që do të përdoret nga sektori RETRO për kontrollin e mjeteve historike.
- Prona të jetë e pozicionuar në vend të favorshëm për kryerjen e aktivitetit të DRSHTRR-së Tiranë si dhe QKT-së, ku kusht është lidhja e saj me rrugë urbane ku të levizin lirshëm makineri të tonazhit të rëndë;
- Prona të jetë e rrethuar sipas certifikatës së pronësisë;
- Prona të ketë akses të lidhjes me rrjetet inxhinierike të jashtme (lidhja me energji elektrike, ujësjellës, kanalizime, telefoni, internet etj);



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Rr. "Muhedin Llagani" Nr.10, Tiranë;
Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0) 42238175 e-
mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

- Objekti duhet të ketë funksional rrjetin elektrik të brendshëm të përshtatshëm për zyra, rrjetin elektrik të jashtëm për ndricimin e sheshit (hapesires) dhe sistemin e monitorimit me kamera sigurie;
- Objekti duhet të ketë funksional linjat dhe rrjetin informatik i cili të jetë i shpërndarë në të gjithë godinën, duke përfshirë edhe dhomën e serverit;
- Objekti duhet të ketë të vendosur dhe funksional sistemin e mbrojtjes nga zjarri.
- Objekti duhet të jetë i pajisur me sistemin dhe sinjalistikën e duhur të emergjencës.
- Godina duhet të jetë e pajisur me gjenerator për të siguruar energji elektrike pa ndërprerje.
- Godina duhet të ketë infrastrukturën e nevojshme për furnizim me ujë pa ndërprerje;
- Objekti duhet të ketë të instaluar dhe funksional sistemin e kondicionimit ngrohje/ftohje në të gjithë hapësirën;
- Objekti duhet të jetë i pajisur me:
 - Ndricues në të gjithë ambientin,
 - Tavolinë pune për çdo punonjës,
 - Karrige për çdo punonjës,
 - Komodinë personale për çdo punonjës,
 - Tavolinë dhe karrige për recepsionin,
 - Karrige ulëse në zonën e pritjes,
 - Raftë për dokumenta për çdo punonjës,
- Ambienti duhet të ketë infrastrukturën e nevojshme për aksesin e personave me aftësi të kufizuara;
- Ambienti të ketë sistem monitorimi me kamera 24 orë;
- Ambienti të ketë tualete, jo më pak se 5 (pese) bokse, me pajisjet e nevojshme hidrosanitare;
- Objekti duhet të ketë hapësirën e duhur që do të shërbejë si mense për plotësimin e nevojave të punonjësve;
- Ambientet të jenë të gjitha të shtruar me pllaka, të patinuara, të lyera, me dyer të brendshme dhe të jashtme, dritare sipas standartit dhe me të gjithë rifiniturën e brendshme e të jashtme të nevojshme;
- Ambientet të ketë dalje në tavane për ndriçim dhe çelësa për komandimin e tyre;
- Godina të jetë e suvatur dhe e lyer në sipërfaqen e jashtme;
- Ambienti rrethues të jetë i sistemuar në mënyrë që të lejojë funksionimin normal të aktivitetit të DPSHTRR-së, Task Forcës, Sektorit të Taksave (Tirana 1) dhe QKT-së Prezë, etj;
- Ofertuesi duhet të ketë minimalisht 110 poste pune (rrjeti Lan) të shpërndara në të gjithë hapësirën ku gjithashtu të ketë edhe dy poste energjie;
- Të ketë minimumi një server room ku terminojnë të gjitha lidhjet e rrjetit Lan dhe të jenë të qepura në Patch Panele me etiketimin përkatës. Në brendësinë e server room të ketë një Rack 42' ne të cilin do të jenë të montuara aparaturat si Router, Switch, sistem inverter dhe Patch Panele;
- Switch-et duhet të jenë me porta Gigabit të menaxhueshëm dhe POE, të kenë minimalisht 120 porta. Këto Switch-e të jenë Rack Mounti.

Shënim: Me post pune nënkuptohet blloku prej 2 prizave fuqie dhe 1 prizë rrjeti informatik RJ45.

2. Ofertat që do të paraqesin konkurrentët për konkurrim përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- Kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurrim;



- Oferta e ofertuesve me cmim për m² truall dhe m² ndërtesë
- Ofertuesi duhet të vërë në dispozicion një kopje të noterizuar të certifikatës së pronësisë së bashku me dokumentacionin shoqërues: kartelë dhe hartë treguese të përditësuar, brenda 3 (tre) muajve të fundit.
- Vërtetimin nga autoriteti përkatës për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, për statusin juridik të sipërfaqes së tokës dhe objektit (godinës);
 - Deklaratën noteriale nga pronari i pasurisë së paluajtshme që nuk ka konflikt me palë të treta;
 - Ofertuesi duhet të vërtetojë që ka shlyer të gjitha detyrimet, sipas legjislacionit në fuqi;
 - Gen-plan, ku përcakton vend-ndodhjen dhe sipërfaqen e ambjentit të ofruar si dhe planimetrinë të hartuar nga një inxhinier/subjekt i licensuar.
- Komisioni i negocimit rezervon të drejtën për verifikimin në vend të godinës me kriteret e kërkuara para marrjes së një vendimi përfundimtar.

Ky dokumentacion të paraqitet në një zarf, të mbyllur, nënshkruar nga ofertuesi, me mbishkrimin “Ofertë për blerje trualli dhe godine për sistemimin e punonjësve të DPSHTRR-së” dhe i dorëzohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, në datën dhe orën e hapjes së konkurrimit. Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje e noterizuar.

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme, përbën kusht skualifikues.

Vendi i zhvillimit të konkurrimit: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, zyra e protokollit, me adresë: Adresa: “Rr. “Muhedin Llagani” Nr.10”, Tiranë; Tel.: +355 69 801 5 833 Fax.: +355 (0) 4 2238175;

Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/konkurrentët, fizikisht, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave konkurruese do të jete data: 15/05/2021 ora 10:00.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Blendi GONXHJA



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Rr. “Muhedin Llagani” Nr.10,Tiranë;
Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0) 42238175 e-
mail:dpshttr@dpshttr.gov.al;www.dpshttr.gov.al